

Urdhri i Infermierit është Ent publik jobuxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkëta të profesioneve: infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre, në funksion të publikut.

Urdhri i Infermierit ka si mision ruajtjen e standardeve të miratuara nga Ministri i Shëndetësisë në ushtrimin e profesioneve infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie, logopedist/e, nëpërmjet mbikëqyrjes së normave të Kodit Etik-Deontologjik, si dhe mbrojtjes së pacientëve dhe të publikut nga kequshtrimi i këtyre profesioneve. Në përmbushje të këtij misioni:

a) Kryen regjistrimin e infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e në regjistrin përkatës të këtij Urdhri;

b) Mbikëqyr zbatimin e detyrave profesionale, në përputhje me kërkesat e shkencave mjekësore, rregullat e etikës dhe Kodin Etik-Deontologjik;

c) Siguron udhëheqjen etiko-morale e deontologjike të bashkësisë së infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e, pavarësinë e ushtrimit të profesionit dhe mbron interesat moral të këtij profesioni;

ç) Mbron interesat e pacientëve dhe të publikut nga kequshtrimi i mjekësisë dhe shkelja e Kodit Deontologjik Mjekësor nga ana e infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e;

d) Bashkëpunon për zhvillimin e standardeve profesionale, për planifikimin, hartimin dhe zhvillimin e programeve të formimit profesional,

e) Realizimin e trajnimeve të ndryshme në fushën e edukimit në vazhdim të infermier/e, mami, fizioterapeft/e, teknik/e laborator, teknik/e imazherie dhe logopedist/e;

dh) Konfirmon anëtarësinë në Urdhrin e Infermierit, nëpërmjet dhënies dhe ridhënies së Lejës së Ushtrimit të Profesionit.

e) Garanton që anëtarët e Urdhrit përmbushin detyrimet e programit të ricertifikimit, të vendosur nga institucioni përkatës.

### **Tarifat e dokumentave që lëshohen nga Urdhri I Infermierit të Shqipërisë**

	<b>Lloji i dokumentit</b>	<b>Tarifa</b>
1.	Karta e identitetit profesional	200 Lek
2.	Depozitim dosje për anëtarët e rinj	1 500 Lek
3.	Leja e të drejtës së ushtrimit të profesionit	5 000 Lek
4.	Kuotizacioni 5-vjecare për profesionistet si Infermier, Mami, Infermieri-Mami, Fizioterapi, Teknik-Imazherie, Teknik-Laboratori, Logopedi	6 000 Lek
5.	Tarifa e ricertifikimit (1 herë në 5 vjet)	5 000 Lek
6.	Dublikatë i lejes së ushtrimit të profesionit	1 000 Lek
7.	Tarifa për kryerjen e praktikës profesionale	3 000 Lek
8.	Vërtetim për sjellje të Mirë	1 000 Lek
9.	Vulë për jashtë	1 000 Lek
10.	Vërtetim për orë praktike	1 000 Lek
11.	Vërtetim Program Praktike të detajuar	2 000 Lek

**Këto pagesa do të bëhen pranë këtyre bankave, në këto numra llogarie :**

	<b>BANKA</b>	<b>Nr. llogarie</b>
1.	Banka Credins	145351
2.	Banka Raiffeisen	0100927928
3.	Intesa SanPaolo Bank	2022930901
4.	Tirana Bank	0130-309114-100
5.	Banka Kombetare Tregtare	416284099

Të gjitha këto shërbime ofrohen nëpërmjet Platformës Digjitale: **[app-uish.org](https://app-uish.org)**.